




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
Më: 26.08.2019

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Me kohë të caktuar / zëvendësim	Numri i pozitave
1	SHFMU "Ardhmëria" Beleg	Punëtor Teknik - Pastrues	Me kohë të caktuar	1
2	SHFMU "Drita" Gramaçel	Mësimdhënës për Edukimin Parashkollor	Zëvendësim i lehonisë më kohë të caktuar	1
3	SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan	Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe	Zëvendësim i lehonisë më kohë të caktuar	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Trajnime (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka);
- Certifikata e lindjes
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 të datës: 20.07.2018.

Fakulteti i Edukimit – Programi parashkollor;
Shkolla e Lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatore;
Fakulteti Filozofik –dega e pedagogjisë së përgjithëshme.
Fakulteti i shkencave sociale –programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve

Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajë dhe të pastrojë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;

Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;

Të identifikoj, të evidentoj, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizim ose harxhimin e mjeteve të punës;

Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës të ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52, në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori

Ma. sc. Bekim Visha

